

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**GJYKATA RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Nr. 2397 Vendimit

**V E N D I M**

**PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot, me daten 31.10.2008, une, *gjqtarja, Blerina Meca*, e gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga kerkuesi, z. **JONID JORGJI**, per rregjistrimin e organizates jofitimpruese "Shoqata e Kineasteve te rinj-Belmond" dhe pasi shqyrtova gjithë dokumentacionin e paraqitur prej saj,

**K O N S T A T O V A**

Se kerkuesi, **JONID JORGJI**, me cilesine e Presidentit te shoqates, i eshte drejtuar Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane me nje kerkese me te cilen ai kerkon te rregjistroje si person juridik organizaten jofitimpruese "Shoqata e Kineasteve te rinj-Belmond". Per kete ai bashkangjitur kerkeses ka paraqitur edhe kopjen e noterizuara Aktit te Themelimit e te Statutit te kesaj shoqate.

Nga dokumentat e mesiperme shoqata ka keto te dhena :

- 1- Emri i organizates eshte "Shoqata e Kineasteve te rinj-Belmond"
- 2- Shoqata eshte organizate jofitimpruese dhe pa qellime politike.
- 3- Selia e shoqates eshte ne Tirane, rruga : Prokop Mima, pallatet Tirhino, kulla A.
- 4- Shoqata ka afat te papercaktuar.
- 5- Presidenti dhe perfagesuesi i shoqates eshte z. JONID JORGJI.
- 6- Organizata ka per qellim dhe synim : Evidentimin, perzgjedhjen dhe nxitjen e vlerave kombetare e nderkombetare ne fushen e gjinive te ndryshme te kinematografise, te filmit televiziv, artistik, dokumentar, alternativ, te animuar, te metrazhit te gjate, te mesem e te shkurter, qe shprehen ne maredheniet autor-realizues-spektator.

Aktivitetet e fushat e veprimtarise te organizates jane :

- a- Nxjerrja ne pah e risive te ndryshme kinematografike, ne drejtim te formave dhe koncepteve bashkekohore ne funksion te integritit te veprave kombetare ne kulturen boterore.





b- Zbatimi i projekteve dhe programeve te ndryshme per veprat e reja, si dhe i risive te shkences ne fushen e kinematografise.

Bashkerendimi dhe bashkepunimi i ngushte me institucionet e njejta ne kudo ne bote per te mundesuar paraqitjen te veprave tona kimetografike.

d- Bashkepunimi dhe bashkerendimi i ngushte me institucionet qendrore, lokale dhe entet e ndryshme shteterore te vendit, me organizatat e ndryshme joqeveritare dhe me donatore publike e private te vendit dhe te huaj.

e- Nxitja dhe inkurajimi i talenteve te reja dhe dhenia e mundesive e tyre per shfaqjen e aftesive dhe vlerave te tyre.

f- Shtrirja gjeografike dhe qarkullimi i vlerave te mesiperme ne te gjithë territorin e vendit tone dhe trevave shqiptare, per te rigjeneruar jeten kulturore, si ne zonat urbane dhe ne zonat rurale.

g- Te mare persiper organizimin dhe te realizoje zbatimin e projekteve, spektaklesh, panairesh, promovimesh, seminaresh, konferenca, kualifikimesh shkencore ne fushen kimetografike me eksperte te vendit e te huaj.

Mbeshtetur ne dokumentacionin e mesiperme cmoj se kerkesa e bere prej kerkuesit Jonid Jorgji, per regjistrimin e organizates jofitimpruese, eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj e ne prova dhe si e tille ajo duhet pranuar.

#### **PER KETO ARESYE**

Ne baze te ligjit 8788 dt 07.05.2001 "Per organizatat jofitimpruese" e ligjit 8789 dt 07.05.2001 "Per rregjistrimin e organizatave jofitimpruese"

#### **V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses.

1- Rregjistrimin e Organizates "Shoqata e kineasteve te rinj-Belmond".

2- Shoqata eshte organizate jofitimpruese dhe pa qellime politike.

3- Selia e shoqates eshte ne Tirane, rruga Prokop Mima, pall. Tirhino, kulla A.

4- Shoqata ka afat te veprimtarise te papercaktuar.

5- Presidenti dhe perfaqesuesi i shoqates eshte z.Jonid Jorgji.

6- Shoqata ka per qellim e synim : Evidentimin,perzgjedhjen dhe mbajtjen e vlerave kombetare e nderkombetare ne fushen e gjinive te ndryshme,te kinematografise,te filmit televiziv,artistik,dokumentar,alternativ,te animuar,te metrazhit te gjate,te mesem e te shkurter,qe shprehen ne maredheniet autor-realizues-spektator.

Aktivitetet e fushat e veprimtarise te organizates jane :

a- Nxjerrja ne pah e risive te ndryshme kinematografike,ne drejtim te formave dhe koncepteve bashkekohore ne funksion te integritimit te veprave kombetare ne kulturen boterore.

b- Zbatimi i projekteve dhe programeve te ndryshme per veprat te reja,si dhe i risive te shkences ne fushen e kinematografise.

c- Bashkerendimi dhe bashkepunimi i ngushte me institucionet e njejta ne kudo ne bote per te mundesuar paraqitjen te veprave tona kimetografike.

d- Bashkepunimi dhe bashkerendimi i ngushte me institucionet qendrore,lokale dhe entet e ndryshme shteterore te vendit, me organizatatat e ndryshme joqeveritare dhe me donatore publike e private te vendit dhe te huaj.

e- Nxitja dhe inkurajimi i talenteve te reja dhe dhenia e mundesive e tyre per shfaqjen e aftesive dhe vlerave te tyre.

f- Shtirirja gjeografike dhe qarkullimi i vlerave te mesiperme ne te gjithë territorin e vendit tone dhe trevave shqiptare per te rigjeneruar jeten kulturore,si ne zonat urbane dhe ne zonat rurale.

g- Te mare persiper organizimin dhe te realizoje zbatimin e projekteve, spektaklesh,panairesh,promovimesh,seminaresh,konferenca,kualifikimesh shkencore ne fushen kinematografike me eksperte te vendit e te huaj.

7- Per aktivitetet qe kerkohet licensim sipas ligjes,ato do te kryhen nga shoqata vetem kur ajo do te pajiset me lejen perkatese nga organet kompetente shteterore.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjes.

U shpall sot me daten 31.10.2008 ne Tirane.

